



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk. II..nr.803/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitia Ymeri, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve-propozuesve të sigurimit S.K.B, Sh.Q dhe L.Q të gjithë me vendbanim në Prishtinë, të cilët përfaqësohen sipas autorizimit nga F.Q avokat nga Prishtina, kundër paditurit-kundërshtarit të sigurimit Sh.B nga Prishtina të cilin e përfaqëson me autorizim I.G avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kundër propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike E.K.nr.579/21 datës 08.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundër propozuesit të sigurimit Sh.B nga Prishtina, dhe VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.579/21 e datës 18.12.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar EK.nr.579/21 datës 08.12.2021, e ka Hudhur si të palejuar revizionin e kundër propozuesit të sigurimit Sh.B nga Prishtina, i paraqitur kundër Aktvendimit Ae. nr.248/21 dt.29.1.2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i kundër propozuesit të sigurimit me arsyetimin se aktvendimi i kontestuar nuk i plotëson kushtet ligjore gjegjësisht nuk është i bazuar në dispozitat e LPK-së neni 228 par.1 dhe 2 dhe neni 230. Gjykata e Shkallës së parë bie në kundërshtim me vet konstatimet e saj ku thuhet “Revizioni lejohet vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë”, e që në rastin konkret kemi të bëjmë pikërisht me një aktvendim të tillë. Po ashtu Gjykata do duhej të ketë parasysh se për çështjen konkrete e cila do të vendoset me Aktgjykim për kërkesën kryesore do jetë i lejuar revizioni domosdoshmërisht referuar neni 228.1 të LPK-së, I propozon Gjykatës së shkallës së dytë që pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës të aprovoj ankesën si të bazuar, ashtu që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe Revizioni i kundërrpropozuesit Sh.B i ushtruar me datë 22.11.2021 të konsiderohet i lejuar.

Propozuesit e sigurimit nuk kanë dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së neni 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kundërshtari i sigurimit Sh.B nga Prishtina të cilin e përfaqëson me autorizim I.G avokat nga Prishtina, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 22.11.2022, ka paraqit Revizion kundër Aktvendimit Ae.nr.248/2021 dt.29.10.2021 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, me propozimin që aktvendimi i atakuar të priset dhe të aprovohet aktvendimi i shkallës së parë EK.nr.579/2021 dt.05.10.2021 apo kjo qështje juridike të kthehet në rishqyrtim apo rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me Revizionin e parashtruar nga kundërshtari i sigurimit, ka marrë Aktvendimin e atakuar EK.nr.579/21 e datës 18.12.2021, me të cilin e ka Hudhur si të palejuar Revizionin e kundër propozuesit të sigurimit Sh.B nga Prishtina, i paraqitur kundër Aktvendimit Ae. nr.248/21 dt.29.1.2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë. Në asyetim të këtij vendimi gjykata e shkallës së parë thekson se Revizioni është i palejuar në kuptim të nenit 228 paragrafi 1 të LPK-së, dhe se në rastin konkret nuk kemi një vendim gjyqësor të gjykatës së shkallës së dytë, por me një kërkesë aksesore-masë e sigurimit të propozuesve

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, ka analizuar pretendimet ankimore dhe shkresat e lëndës, dhe erdh në përfundim se këto pretendime nuk gjejnë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi e shkallës së parë, sepse në vështrim të nenit 228 paragrafi 1 të LPK-së, Revizioni si mjet i jashtzakonshëm juridik, lejohet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë kur përfundon procedura në gjykatën e shkallës së dytë. Dhoma e Shkallës së Dytë pranon qëndrimet vendimit të atakuar se në këtë qështje juridike nuk kemi një vendim gjyqësor të plotfuqishëm gjykatës së shkallës së dytë, por me një kërkesë aksesore të propozuesve masë e sigurimit të kërkespadiës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dhe se arsyetimi i vendimit përmban arsye të mjaftueshme ligjore për të vendosur në këtë qështje juridike, të cilat në tërsi i aprovon Dhoma e Shkallës së Dytë.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, dhe nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk. II..nr.803/2022 datë 05.09.2022

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Krenar Berisha